

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“REHABILITIMI I KANALIT “THOMA FILIPEU” , (LOTI 1) ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45247111 - 1 PUNIME NDËRTIMI PËR KANALE UJITËSE

VLERA E FONDIT LIMIT:

103 188 794 (NJË QIND E TRE MILION E NJË QIND E TETËDHJETË E TETË MIJË E SHTATË QIND E NËNTËDHJETË E KATËR) LEKË PA TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Finiq** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga*

autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe si dhe ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, te ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit të kontratës/marrëveshjes kuadër..

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar për te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9 dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 germa “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar*

kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren dhe nenit 39, pika 5, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik"...Per te provuar pervojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **40%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **sa** vlera limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit te ulet dhe te larte monetar, punët e mëparshme të ngjashme jane minimalisht në vlerat vlerat **40%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **sa** vlera limit e kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim te konkurrences.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",neni 39,pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit" (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve te ndërtimit",Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 "Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit " te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në

bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e percaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zerrat e punimeve që ka realizuar, koha e realizimit, dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vleresimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor, elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1 Niveli A “Punime germimi në tokë”

NP-7 Niveli C “Ujesjellesa, gazsjellesa, vepra kullimi e vaditje”

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-8 Niveli A “Ndertime p/f me beton të armuar struktura metalike dhe druri”.

NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave

profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane..". Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:**

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier topograf
- 1 (një) inxhinier hidraulik

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomë, Kontratë pune, CV, Librezë Pune

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *"Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla"*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *"Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin..."*.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjsuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie" në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe ligjin 8402 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" date 10.09.1998 i ndryshuar

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në *realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, topograf dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2 , kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP-1, NP-4 etj** është e nevojshme prezenca e

Inxhinierit të Ndërtimit. pasi kjo veper parashikon realizimin e Punimeve te germimit ne toke, Rikonstruksion dhe M/M godina civile dhe industriale etj.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP-7** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit hidroteknik** pasi kjo veper parashikon realizimin e punimeve hidrike .

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP-7** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit topograf** pasi kjo veper parashikon punime matjet topogjeodezike .

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë/dëshmi ose certifikatë përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore , si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit , si më poshtë:

- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. ((Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" sipas zerave te punimeve qe marrin persiperne realizim e kontrates).

- Teknik ndertimi	1 (një) punonjes
- Teknik topograf	1 (një) punonjes
- Betonues	4(kater) punonjës
- Hekurkthyes	2(dy) punonjes
- Karpentier	2 (dy) punonjës
- Saldator	2(dy) punonjes
- Punonjës të konstruksioneve metalike	1 (një) punonjes
- Manovrator	3(tre) punonjes

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjsuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht Te gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria

përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Kërkesa për deshmite të manovratoreve bazohet në Urdhërin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **60 gjashtëdhjetë) persona** . Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën muajin e fundit.
- b.** Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...*”.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

1	Mjet transporti veteshkarkues >10 ton (kapac.mbajtes)	4 copë	Në pronësi ose me qera
2	Autobetonjerë me kapacitet 2.5 - 3.5 m ³ (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Ne pronesi ose me qera
3	Tokmak elektrik	1 cope	Ne pronesi ose me qera
4	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 copë	Ne pronesi ose me qera
5	Minifadromë (mjet teknologjik me goma)	2 copë	Ne pronesi ose me qera
6	Fadromë me goma (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Ne pronesi ose me qera
7	Elektrosaldatriçe	1 copë	Ne pronesi ose me qera
8	Autovinc	1 cope	Ne pronesi ose me qera
9	Vinc kulle	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Autobetoniere	2 cope	Ne pronesi ose me qera
11	Autopompe betoni	1 cope	Ne pronesi ose me qera
12	Fabrike per prodhim betoni jo me large se 30 km nga objekti	1 cope	Ne pronesi ose qera ose me kontrate furnizimi.
13	Fabrike per prodhim inertesh	1 cope	Ne pronesi ose qera ose me kontrate furnizimi.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pikë operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë

e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.

iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.

iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne regjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionii mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërtetonpronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

v. **Fabrika duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendodhje jo më larg se 30 km nga objekti dhe e paisur me leje mjedisore. Pra fabrika duhet të jetë aktualisht e montuar dhe në gjendje pune dhe me leje mjedisore për këtë vendodhje. Gjithashtu duhet të paraqitet edhe planvendosja edhe fotografi të fabrikës në vendodhjen aktuale brenda kritereve.**

Disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe

specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit.

Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë.

Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.4.Kritere të veçanta:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
- Çertifikatë 3834-4:2021 ‘Per cilesine e saldimit te materialeve metalike’ ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

* Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Janë të vlefshme edhe çertifikimet e lëshuara nga organi i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Republika e Shqipërisë, të njohura dhe lëshuara sipas Standardeteve shqiptare të Drejtorisë së përgjithshme të Standardeve.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe shëndeteti të sigurisë në punë. Kjo çertifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohet edhe ekuivalentja e saj dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Neni 79 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Duke marrë në konsideratë se gjatë realizimit të punëve ka edhe procese saldimi gjykohet e nevojshme edhe pasja e Çertifikatë 3834-4:2021 ‘Per cilesine e saldimit te materialeve metalike’.

Neni 44, pika 1 dhe pika 3 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar për çdo zë pune. Grafiku i punimeve dhe afati përcaktuar janë pjese e dokumentacionit të tenderit të hartuar dhe kontrolluar nga struktura tenike e posacme.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 39, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu në nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

2.4.3 Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), së bashku me aktin e miratimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Po ashtu, referuar preventivit të punimeve, duke qenë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu, kanale), prishje struktura dhe shtresa rrugore, dhe kryerjen e transportit të tyre në vend-depozitim, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të Ligjit nr. 10 463, datë 22. 09. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 575, datë 24. 06.

2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, ndaj operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas Ligjit nr. 10 081, datë 23. 02. 2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26. 05. 2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.4.4 Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatëse publikuar në DST, për materialet si më poshtë:

a) Tubo Ujësjellësi çeliku

duhet të paraqesin Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i Autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje Bashkëpunimi të zyrtarizuar, ku të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e Bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokumentë paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, paragrafi 1, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se operatori ekonomik i ka kapacitetet për të ofruar furnizim të vazhdueshëm me materialet e nevojshme për kryerjen e punimeve sipas zërave të preventivit. Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga Autoriteti kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, certifikatat e mësipërme shërbejnë për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Kjo referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standardet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testeve të kryera ose ISO, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/vlerësimin nga A.K, nëse këto materiale/pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara në dokumentet e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standardeve të miratuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.